



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04 /955/ 2021

DATA:	08.02.2021
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	Rufki Suma Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA:	Shabi Rexhallari Drejtore për Buxhet dhe Financa
LËNDA:	Raporti financiar për periudhën janar-dhjetor 2020

Të nderuar,

Bazuar në ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe statutit të komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5, gjeni të bashkangjitur raportin financiar për periudhën janar- dhjetor 2020.

Me respekt,



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



Nr. 04/ 955 /2021

Data: 08.02.2021

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

**RAPORT FINANCIAR PËR PERIUDHËN
JANAR-DHJETOR 2020**

HANI I ELEZIT, Shkurt 2021

Përmbajtja

1	Përkufizimet.....	4
2	Hyrje.....	5
2.1	Performanca e të hyrave.....	5
2.2	Performanca e shpenzimeve.....	5
3	Buxheti i komunës së Hanit të Elezit 2020.....	6
3.1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2020/19.....	6
3.2	Raporti i kontrollit buxhetor për vitin 2020	8
3.3	Ekzekutimi i buxhetit për vitin 2020 sipas burimeve të financimit.....	13
4	Shpenzimet sipas kodeve ekonomike për vitin 2020.....	14
4.1	Shpjegime për kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.....	17
4.2	Shpjegime për kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.....	19
5	Financimi i investimeve kapitale për vitin 2020.....	21
6	Raporti i të hyrave vetanake për periudhën janar-dhjetor 2020.....	23
7	Pagesat e bëra për Covid-19 me kod 00099 në kategorinë paga dhe shtesa.....	24
8	Shpenzimet lidhur me Pakon Emergjente në kategorinë mallra dhe shërbime	24
9	Mjetet e shpenzuara nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike me kod 00098.....	25
10	Raporti i obligimeve të papaguara deri 31.12.2020	25

1.Përkufizimet

Bilancet - shumat e zotimeve të papritura, ndarjeve buxhetore të pa alokuara, alokimet e pa zotuar dhe çfarëdo të ardhurash të një shume më të madhe se sa shuma e shpenzimeve dhe zotimet e papritura të bartura nga viti fiskal paraprak;

Organizatat Buxhetore - të gjitha ministritë, komunat, agjencitë dhe institucionet, të cilat pranojnë ndarje buxhetore nga Fondi i Kosovës sipas këtij ligji;

Zotimet - shpenzimet e parashikuara, për të cilat urdhëresa për pagesë të zotimit është plotësuar në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit dhe të cilat janë regjistruar në SIMFK, pa marrë parasysh nëse i nënshtrohen apo jo ndonjë detyrimi ligjor;

Kategoritë e shpenzimeve - kategoritë “Pagat dhe Shtesat”, “Mallrat dhe Shërbimet”, “Shërbimet Komunale”, “Subvencionet dhe Transferet”, “Shpenzimet Kapitale” dhe “Rezervat”.

Viti fiskal - periudhën nga 1 Janari i një viti deri 31 dhjetor të vitit të njëjtë;

Alokimi i fondeve – shuma maksimale për zotime dhe shpenzime që mund të bëhet kundrejt ndarjeve specifike buxhetore, siç është përcaktuar me procedurat e parapara në nenin 34 të LMFP-së dhe të regjistruara në SIMFK;

Subvencionet – fondet e siguruara nga shteti për të ndihmuar kompanitë, personat juridik ose sektorët e veçantë të ekonomisë si për sh. bujqësinë;

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve KASH– Është një dokument i prioriteteve të politikave të Qeverisë që ka për qëllim orientimin e ndarjes së mjeteve buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor. Përkrah parashikueshmërinë në procesin e buxhetit duke siguruar se buxheti bazohet në parashikimin afatmesëm makroekonomik dhe fiskal (zakonisht në një periudhë 3 vjeçare);

Të hyrat vetanake të komunave - çfarëdo e hyre e parasë publike e cila është vlerësuar dhe mbledhur nga komunat nga burimet e specifikuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108;

Burimet e financimit – grantet qeveritare (GQ), të hyrat vetanake (THV), të hyrat e dedikuara (THD), të hyrat nga AKP-ja dhe financimet nga huamarrja brenda deficitit buxhetor (FH);

Transferet - Çdo ndryshim i ndodhur brenda ndarjeve të aprovuara të paraqitura në tabelat 3.1, 3.1 A, 3.1 B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2 nënkupton transferet që janë:

- ndryshimi i shumave të ndara në mes të organizatave buxhetore,
- ndryshimet që ndodhin mes nën-programeve të po të njëjtës organizatë buxhetore dhe
- ndryshimet e ndodhura mes secilës kategori të shpenzimeve të paraqitur në tabelën 3.1, 3.1A, 3.1B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2.

Rialokimet - Çdo ndryshim i ndodhur në tabelën 3.2, 3.2B; dhe 4.2 në kategorinë e shpenzimeve kapitale brenda një nën-programi të një organizate buxhetore;

2. Hyrje

Raporti financiar për periudhën janar - dhjetor 2020, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe statutin e komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5.

Ky raport përmban një përmbledhje të trendeve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës janar - dhjetor 2020. Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, pasqyron të hyrat sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave si dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe projeksionet buxhetore.

2.1. Performanca e të hyrave

Të hyrat vetanake kanë arritur vlerën e arkëtimit 244,099.82 euro apo 76.79% e planit duke pasur një rënie me 23.21% që korrespondon me 73,765.18 euro më pak krahasuar me planin vjetor të parashikuar që ka qenë në shumë prej 317,865.00 euro. Pas situatës së krijuar me pandeminë me COVID-19 me vendim të kuvendit komunal kemi liruar taksat e ushtrimit të veprimtarisë afariste për tre (3) muaj dhe taksat për shfrytëzimin e pronave publike (qiratë) për gjashtë (6) muaj, që në total lirimi nga taksat ka qenë në shumë prej 22,870.06 euro apo 7.19% e planit (317,865.00 €), (shih raportin fq. 23).

2.2. Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore kanë arritur vlerën prej 3,087,211.70 euro apo 94.20% e projeksioneve buxhetore të vitit 2020 që kanë qenë në shumë prej 3,277,468.59 euro, ndërsa në krahasim me shpenzimin e vitit paraprak kemi një rënie prej 1.47% që korrespondon me 45,997.56 euro.

- **Shpenzimet për paga dhe shtesa** shënuan vlerën e 1,577,266.70 € gjatë këtij viti, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 99.53% me vlerën totale të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet për paga dhe shtesa gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 6.66% apo 98,493.26 euro më shumë krahasuar me shpenzimet e pagave për vitin 2019.

Kjo rritje është si pasojë e situatës me pandeminë COVID-19, ku Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Planin Operacional për Pakon Fiskale Emergjente, ku në kuadër të këtij plani është zbatuar MASA 6 – Sigurimi i shtesës mbi pagë në vlerë prej treqind (300 €) euro ku janë marrur këto vendime për pagë shtesë:

- Vendimi me nr. 31/2020 i datës 03.04.2020 për Pakon Fiskale Emergjente, ku kanë përfituar sigurim të shtesës mbi pagë në vlerë prej treqind (300 €) euro për 2 muaj (prill dhe maj 2020) për punëtorët që kanë qenë në terren dhe që janë ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në punën e tyre si: stafi mjekësor dhe mbështetës (mjekët, infermierët dhe personeli tjetër i ekspozuar rrezikut), pastaj inspektorët e inspektorateve komunale, zjarrfikësit, në shumë prej 23,940.00 €.
- Vendimi me nr. 05/18 të marrur me datën 29.07.2020 nga Qeveria e Republikës së Kosovës për shtesën mujore mbi pagë në vlerë prej treqind (300 €) euro vetëm për personelin publik shëndetësor - QKMF-të në kuadër të komunave për 2 muaj (korrik dhe gusht 2020) për angazhim shtesë, për ekspozim të drejtpërdrejtë rrezikut të infektimit në punën e tyre, në shumë prej 19,845.00 €.

- Vendimi me nr. 18/38 të datës 30.10.2020 shtesa mujore mbi pagë bazë për personelin shëndetësor publik për:
 - kategorinë **I** – mjekë në shumë prej 250.00 € në muaj,
 - kategorinë **II**- infermierët në shumë prej 150.00 € në muaj dhe për
 - kategorinë **III** - staf mbështetës/teknik në shumë prej 100.00 € në muaj të angazhuar në betejën kundër pandemisë COVID-19 për muajin shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2020, në shumë prej 22,155.00 €.
- Vendimi me nr. 06/38 të datës 30.10.2020, për shërbimin e zjarrfikësve, kompensim për ndërrime nate, festa zyrtare dhe orë shtesë për vitin 2020 në shumë prej 6,930.00 €.
- Për shkak të donacionit të fituar me Bashkimin Europian (IPA FONDET) për projektin “Aksione të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e sistemit të kanalizimit dhe ujërave të zeza në fshatin Seçishtë” janë të punësuar dy (2) punëtorë, ku shpenzimi për periudhën qershor-dhjetor 2020 apo 7 muaj është në shumë prej 10,500.00 €.
- Pastaj, pagesat për jubile dhe pagat përcjellëse pas pensionimit të arsimtarëve dhe të administratës komunale, shtesat dhe kompensimet tjera për ndërrime nate, festa zyrtare dhe orë shtesë për vitin 2018 për shërbimin e zjarrfikësve, ekzekutuar në muajin mars 2020 me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës në vlerë prej 6,048.00 €, pagesat e orëve shtesë për stafin e shëndetësisë që kanë qenë të angazhuar në pikën kufitare për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Kompensimet e orëve shtesë si për zëvendësimet e arsimtarëve, zëvendësimet e lehonave, kompensimet për inspektorët komunal për punë jashtë orarit gjatë pandemisë dhe kompensimet tjera për shërbyesit civil.
- **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** shënuan vlerën prej 382,355.03 € duke shënuar një rritje prej 120,529.08 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit 87.62% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori ose rritje prej 46.03% krahasuar me vitin 2019.
- **Shpenzimet komunale** shënuan vlerën prej 61,959.21 € duke shënuar një rritje prej 7,590.48 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit 99.93% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori ose rritje prej 13.96% më shumë krahasuar me vitin 2019.
- **Shpenzimet për subvencione dhe transfere** arritën shumën prej 155,945.50 € që paraqet një rritje prej 89,842.10 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit 96.72% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori apo 135.91% më shumë krahasuar me vitin 2019.
- **Shpenzimet kapitale** arritën vlerën prej 909,685.26 € që paraqet një normë të lartë të ekzekutimit në 88.05% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori ose një rënie prej 362,452.48 € apo 28.49% më pak krahasuar me vitin 2019.

3. BUXHETI I KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2020

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas ligjit me nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2020 ka qenë në lartësi prej **2,742,094.82 Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 1,519,196.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 303,236.00 €,
- Shpenzimet komunale..... 60,000.00 €,
- Subvencione dhe transfere... 61,104.00 €,
- Shpenzime kapitale..... 629,772.00 €,
- Rezervat..... 168,786.82 €,
- Totali i buxhetit..... 2,742,094.82 €.

Ndërsa buxheti përfundimtar është në shumë prej 3,277,468.59 €, që d.m.th. është rritur buxheti edhe për 535,373.77 € duke përfshirë:

- Bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2019 në shumë prej 85,891.91 €;
- Donacionet e pashpenzuara të vitit 2019 në shumë prej 114.08 €;
- Donacioni nga DEMOS – për Ngritjen e performancën komunale 2020, në shumë prej 49,315.00 €; këto mjete janë shfrytëzuar sipas marrëveshjes për projektin “Ndërtimi i sallës së sportit në SHFMU Gorancë”;
- Donacioni nga UNIONI EUROPIAN (IPA FONDET) në shumë prej 61,738.34 € (Kësti i parë) për projektin “Aksione të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit përmes përmirësimit të sistemit të ujërave të zeza dhe sistemit të kanalizimit në fshatin Seçishtë”;
- Buxhet shtesë me rishikim të buxhetit nga Qeveria e Kosovës për funksionalizimin e Çerdhes së fëmijëve në vlerë prej 45,000.00 € dhe shtimin e stafit prej 13 personave;
- Mbështetje financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas vendimit me nr. 01/23 të datës 13.08.2020 pika 1.2 e MASËS 12, sipas Planit për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, në vlerë prej 281,412.61 €;
- Mbështetja financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas vendimit me Nr. 01/23 të datës 13.08.2020 për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike lidhur me MASËN 11 – Mbështetja e sektorit arsimit për të mundësuar fillimin dhe mbarëvajtjen me sukses të mësimin gjatë vitit shkollor 2020/21, në vlerë prej 16,381.13 €;
- Buxhet shtesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas vendimit me Nr. 06/38 të datës 30.10.2020 përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme për bartjen e mjeteve në komunë në kategorinë paga dhe shtesa për shërbimin e zjarrfikësve, në vlerë prej 6,930.00 €;
- Zvogëlimi i buxhetit në kategorinë paga dhe shtesa nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas vendimit me Nr. 09/50 dt. 21.12.2020 në vlerë prej 11,409.30 €, si kursime.

3.1. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2020 SI DHE KRAHASIMI 2020/ 2019

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Buxheti 2020	Shpenzimi 2020	%	Buxheti 2019	Shpenzimi 2019	%
Paga dhe shtesa	1,584,766.70	1,577,266.70	99.53%	1,493,148.00	1,478,773.44	99.04%
Mallra dhe shërbime	436,366.99	382,355.03	87.62%	262,141.90	261,825.95	99.88%
Shpenzime komunale	62,000.00	61,959.21	99.93%	54,400.00	54,368.73	99.94%
Subvencione dhe transfere	161,240.87	155,945.50	96.72%	66,240.27	66,103.40	99.79%
Shpenzime kapitale	1,033,093.21	909,685.26	88.05%	1,329,617.91	1,272,137.74	95.68%
Rezervat	0.82	-	0.00%	-	-	-
TOTALI	3,277,468.59	3,087,211.70	94.20%	3,205,548.08	3,133,209.26	97.74%

Komente dhe shpjegime:

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për vitin 2020 është në shumë prej **3,087,211.70 € apo 94.20 %**.

Sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për:

- Paga dhe shtesa janë shpenzuar 1,577,266.70 € apo 99.53 %,
 - Mallra dhe shërbime 382,355.03 € apo 87.62 %,
 - Shpenzime komunale 61,959.21 € apo 99.93 %,
 - Subvencione dhe transfere 155,945.50 € apo 96.72 % dhe
 - Shpenzime kapitale 909,685.26 € apo 88.05 %.
- Shpenzimet për kategorinë Paga dhe shtesa për vitin 2020 janë më të larta për 6.66 % apo 98,493.26 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2019;
 - Shpenzimet për kategorinë Mallra dhe shërbime për vitin 2020 janë më të larta për 46.03 % apo 120,529.08 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2019;
 - Shpenzimet për kategorinë Shpenzime komunale për vitin 2020 janë më të larta për 13.96 % apo 7,590.48 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2019;
 - Shpenzimet për kategorinë Subvencione dhe transferet krahasuar me vitin 2020 janë më të larta për 135.91 % apo 89,842.10 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2019;
 - Shpenzimet për kategorinë Shpenzime kapitale për vitin 2020 janë më të ulëta për 28.49% apo 362,452.48 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2019;
 - Gjithsejtë shpenzimet për vitin 2020 për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve janë më të ulëta për 1.47% apo 45,997.56 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2019.

3.2. RAPORTI I KONTROLLIT BUXHETOR PËR VITIN 2020

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Alokimi i mjeteve	Mjetet e pa alokuara	Shpenzimi/ pagesat	Zotim /Obligimet në pritje	Mjetet e lira	Progresi ngaj planit %
CAT / RESP / PCLASS / SUBCL	A	B	A – B	C	D	A - (C + D)	E
04 FINANCIMET NGA HUAMARRJET	17,955.00	17,955.00	0.00	17,955.00	0.00	0.00	100.00%
659 HANI I ELEZIT	17,955.00	17,955.00	0.00	17,955.00	0.00	0.00	100.00%
75050 SHËRBIMET E SHËNDETËSISË PRIMARE	17,955.00	17,955.00	0.00	17,955.00	0.00	0.00	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	17,955.00	17,955.00	0.00	17,955.00	0.00	0.00	100.00%
10 BUXHETI	2,744,589.26	2,744,588.35	0.91	2,710,574.25	33,983.56	31.45	98.76%
659 HANI I ELEZIT	2,744,589.26	2,744,588.35	0.91	2,710,574.25	33,983.56	31.45	98.76%
16035 ZYRA E KRYETARIT	172,304.00	172,303.99	0.01	172,302.81	1.18	0.01	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	69,304.00	69,304.00	-	69,304.00	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	23,000.00	22,999.99	0.01	22,998.81	1.18	0.01	99.99%
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	80,000.00	80,000.00	0.00	80,000.00	0.00	0.00	100.00%
16335 ADMINISTRATA DHE PERSONELI	214,698.89	214,698.87	0.02	208,022.27	6,676.52	0.10	96.89%
11 PAGA DHE SHTESA	98,443.48	98,443.48	-	98,443.48	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	76,887.41	76,887.40	0.01	70,210.80	6,676.52	0.09	91.32%
14 SHPENZIME KOMUNALE	39,368.00	39,367.99	0.01	39,367.99	0.00	0.01	100.00%
16935 ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	63,844.11	63,844.11	0.00	63,844.08	0.03	0.00	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	57,844.11	57,844.11	-	57,844.11	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	6,000.00	6,000.00	0.00	5,999.97	0.03	0.00	100.00%
17535 BUXHET DHE FINANCA	57,623.76	57,623.76	0.00	57,623.76	0.00	0.00	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	54,623.76	54,623.76	-	54,623.76	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,000.00	3,000.00	0.00	3,000.00	0.00	0.00	100.00%
18444 SHËRBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCË	141,160.20	141,160.19	0.01	141,158.21	1.87	0.12	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	78,160.20	78,160.20	-	78,160.20	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	53,000.00	52,999.99	0.01	52,998.01	1.87	0.12	100.00%
30 INVESTIME KAPITALE	10,000.00	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00	0.00	100.00%
19675 ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	7,010.15	7,010.14	0.01	7,010.14	0.00	0.01	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	6,510.15	6,510.15	-	6,510.15	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	499.99	0.01	499.99	0.00	0.01	100.00%
47115 BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE ZHV. RURAL	31,766.09	31,766.08	0.01	31,766.08	0.00	0.01	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	28,266.09	28,266.09	-	28,266.09	-	-	100.00%

13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,500.00	3,499.99	0.01	3,499.99	0.00	0.01	100.00%
48035 ZHVILLIMI EKONOMIK	24,250.72	24,250.71	0.01	24,250.71	0.00	0.01	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	22,250.72	22,250.72	-	22,250.72	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,000.00	1,999.99	0.01	1,999.99	0.00	0.01	100.00%
66480 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	510,587.06	510,587.06	0.00	510,436.82	147.88	2.36	99.97%
11 PAGA DHE SHTESA	51,220.86	51,220.86	-	51,220.86	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	9,000.00	9,000.00	0.00	8,855.05	144.95	0.00	98.39%
30 INVESTIME KAPITALE	450,366.20	450,366.20	0.00	450,360.91	2.93	2.36	100.00%
73044 ADMINISTRATA (SH)	16,756.17	16,755.81	0.36	16,755.81	0.00	0.36	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	15,921.81	15,921.81	-	15,921.81	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	834.00	834.00	0.00	834.00	0.00	0.00	100.00%
38 REZERVAT	0.36	0.00	0.36	0.00	0.00	0.36	0.00%
75050 SHËRBIMET E SHËNDETËSISË PRIMARE	384,564.18	384,564.17	0.01	373,590.92	10,970.75	2.51	97.15%
11 PAGA DHE SHTESA	258,856.18	258,856.18	-	258,856.18	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	104,358.00	104,358.00	0.00	93,423.36	10,932.14	2.50	89.52%
14 SHPENZIME KOMUNALE	6,350.00	6,349.99	0.01	6,311.38	38.61	0.01	99.39%
30 INVESTIME KAPITALE	15,000.00	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00	0.00	100.00%
75671 SHERBIMET SOCIALE	19,835.43	19,835.43	0.00	19,835.27	0.00	0.16	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	16,035.43	16,035.43	-	16,035.43	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,800.00	2,800.00	0.00	2,799.84	0.00	0.16	99.99%
14 SHPENZIME KOMUNALE	1,000.00	1,000.00	0.00	1,000.00	0.00	0.00	100.00%
92175 ADMINISTRATA (A)	249,045.41	249,044.95	0.46	247,589.42	1,444.93	11.06	99.42%
11 PAGA DHE SHTESA	34,044.95	34,044.95	-	34,044.95	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	25,000.00	25,000.00	0.00	23,555.01	1,444.92	0.07	94.22%
30 INVESTIME KAPITALE	190,000.00	190,000.00	0.00	189,989.46	0.01	10.53	99.99%
38 REZERVAT	0.46	0.00	0.46	0.00	0.00	0.46	0.00%
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHE	19,122.71	19,122.70	0.01	17,947.67	1,173.44	1.60	93.86%
11 PAGA DHE SHTESA	4,122.71	4,122.71	-	4,122.71	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	13,000.00	12,999.99	0.01	11,824.96	1,173.44	1.60	90.96%
14 SHPENZIME KOMUNALE	2,000.00	2,000.00	0.00	2,000.00	0.00	0.00	100.00%
94020 ARSIMI FILLOR	672,634.41	672,634.41	0.00	659,055.51	13,566.87	12.03	97.98%
11 PAGA DHE SHTESA	610,534.24	610,534.24	-	610,534.24	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	51,743.17	51,743.17	0.00	38,166.43	13,564.71	12.03	73.76%
14 SHPENZIME KOMUNALE	10,357.00	10,357.00	0.00	10,354.84	2.16	0.00	99.98%
95220 ARSIMI I MESEM	159,385.97	159,385.97	0.00	159,384.77	0.09	1.11	100.00%
11 PAGA DHE SHTESA	142,673.01	142,673.01	-	142,673.01	-	-	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	13,787.96	13,787.96	0.00	13,786.76	0.09	1.11	99.99%

14 SHPENZIME KOMUNALE	2,925.00	2,925.00	0.00	2,925.00	0.00	0.00	100.00%
21 TE HYRAT VETANAKE 2020	317,865.00	222,209.64	95,655.36	187,495.58	12,834.78	117,534.64	58.99%
659 HANI I ELEZIT	317,865.00	222,209.64	95,655.36	187,495.58	12,834.78	117,534.64	58.99%
16035 ZYRA E KRYETARIT	36,000.00	33,700.00	2,300.00	32,690.00	0.00	3,310.00	90.81%
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	36,000.00	33,700.00	2,300.00	32,690.00	0.00	3,310.00	90.81%
16335 ADMINISTRATA DHE PERSONELI	6,512.00	5,139.45	1,372.55	4,130.35	554.71	1,826.94	63.43%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	6,512.00	5,139.45	1,372.55	4,130.35	554.71	1,826.94	63.43%
18444 SHËRBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCË	37,000.00	34,400.00	2,600.00	32,225.49	1,891.52	2,882.99	87.10%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	7,000.00	4,400.00	2,600.00	4,206.21	0.00	2,793.79	60.09%
30 INVESTIME KAPITALE	30,000.00	30,000.00	0.00	28,019.28	1,891.52	89.20	93.40%
47115 BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE ZHV. RURAL	10,104.00	10,104.00	0.00	9,635.50	0.00	468.50	95.36%
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	10,104.00	10,104.00	0.00	9,635.50	0.00	468.50	95.36%
66480 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	167,772.00	88,922.79	78,849.21	71,902.75	4,346.71	91,522.54	42.86%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,000.00	2,000.00	1,000.00	1,984.75	0.00	1,015.25	66.16%
30 INVESTIME KAPITALE	164,772.00	86,922.79	77,849.21	69,918.00	4,346.71	90,507.29	42.43%
75050 SHËRBIMET E SHËNDETËSISË PRIMARE	20,027.00	9,684.40	10,342.60	2,599.85	5,952.28	11,474.87	12.98%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,027.00	4,748.50	278.50	2,599.85	1,016.38	1,410.77	51.72%
30 INVESTIME KAPITALE	15,000.00	4,935.90	10,064.10	0.00	4,935.90	10,064.10	0.00%
75671 SHERBIMET SOCIALE	200.00	59.00	141.00	0.00	0.00	200.00	0.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	200.00	59.00	141.00	0.00	0.00	200.00	0.00%
92175 ADMINISTRATA (A)	40,000.00	40,000.00	0.00	34,311.64	89.56	5,598.80	85.78%
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	15,000.00	15,000.00	0.00	14,500.00	0.00	500.00	96.67%
30 INVESTIMET KAPITALE	25,000.00	25,000.00	0.00	19,811.64	89.56	5,098.80	79.25%
95220 ARSIMI I MESEM	250.00	200.00	50.00	0.00	0.00	250.00	0.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	250.00	200.00	50.00	0.00	0.00	250.00	0.00%
22 TË HYRAT VETANAKE- 2019	85,891.91	85,891.91	0.00	84,716.27	1,000.01	175.63	98.63%
659 HANI I ELEZIT	85,891.91	85,891.91	0.00	84,716.27	1,000.01	175.63	98.63%
16035 ZYRA E KRYETARIT	25,136.87	25,136.87	0.00	23,978.60	1,000.00	158.27	95.39%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,000.00	5,000.00	0.00	4,858.60	0.00	141.40	97.17%
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	20,136.87	20,136.87	0.00	19,120.00	1,000.00	16.87	94.95%
66480 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	25,455.93	25,455.93	0.00	25,455.93	0.00	0.00	100.00%
30 INVESTIME KAPITALE	25,455.93	25,455.93	0.00	25,455.93	0.00	0.00	100.00%
75050 SHËRBIMET E SHËNDETËSISË PRIMARE	5,296.00	5,296.00	0.00	5,279.02	0.01	16.97	99.68%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,000.00	5,000.00	0.00	4,983.02	0.01	16.97	99.66%
30 INVESTIME KAPITALE	296.00	296.00	0.00	296.00	0.00	0.00	100.00%
92175 ADMINISTRATA (A)	30,003.11	30,003.11	0.00	30,002.72	0.00	0.39	100.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,424.67	2,424.67	0.00	2,424.28	0.00	0.39	99.98%

30 INVESTIME KAPITALE	27,578.44	27,578.44	0.00	27,578.44	0.00	0.00	100.00%
32 GRANTE TJERA TË JASHTME	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	0.00%
659 HANI I ELEZIT	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	0.00%
66480 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	0.00%
30 INVESTIME KAPITALE	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	0.00%
49 EU-UNIONI EUROPIAN	61,738.34	61,738.34	0.00	37,155.60	0.00	24,582.74	60.18%
659 HANI I ELEZIT	61,738.34	61,738.34	0.00	37,155.60	0.00	24,582.74	60.18%
66480 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	61,738.34	61,738.34	0.00	37,155.60	0.00	24,582.74	60.18%
11 PAGA DHE SHTESA	18,000.00	18,000.00	-	10,500.00	-	7,500.00	58.33%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	13,542.28	13,542.28	0.00	2,715.00	0.00	10,827.28	20.05%
30 INVESTIME KAPITALE	30,196.06	30,196.06	0.00	23,940.60	0.00	6,255.46	79.28%
59 QEVERIA JAPONEZE	0.40	0.40	0.00	0.00	0.00	0.40	0.00%
659 HANI I ELEZIT	0.40	0.40	0.00	0.00	0.00	0.40	0.00%
18444 SHËRBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCË	0.40	0.40	0.00	0.00	0.00	0.40	0.00%
30 PASURITË JOFINANCIARE	0.40	0.40	0.00	0.00	0.00	0.40	0.00%
60 UN-HABITAT	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.00%
659 HANI I ELEZIT	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.00%
66480 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.00%
30 INVESTIME KAPITALE	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.00%
61 QEVERIA ZVICRANE	49,398.42	49,398.42	0.00	49,315.00	0.00	83.42	99.83%
659 HANI I ELEZIT	49,398.42	49,398.42	0.00	49,315.00	0.00	83.42	99.83%
16335 ADMINISTRATA DHE PERSONELI	0.50	0.50	0.00	0.00	0.00	0.50	0.00%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	0.50	0.50	0.00	0.00	0.00	0.50	0.00%
66480 PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	62.60	62.60	0.00	0.00	0.00	62.60	0.00%
30 INVESTIME KAPITALE	62.60	62.60	0.00	0.00	0.00	62.60	0.00%
92175 ADMINISTRATA (A)	49,315.00	49,315.00	0.00	49,315.00	0.00	0.00	100.00%
30 INVESTIME KAPITALE	49,315.00	49,315.00	0.00	49,315.00	0.00	0.00	100.00%
94020 ARSIMI FILLOR	20.32	20.32	0.00	0.00	0.00	20.32	0.00%
30 INVESTIME KAPITALE	20.32	20.32	0.00	0.00	0.00	20.32	0.00%
Totali i Përgjithshëm	3,277,468.59	3,181,812.32	95,656.27	3,087,211.70	47,818.35	142,438.54	94.20%

- Në këtë tabelë kemi paraqitur buxhetin sipas drejtorive, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve dhe sipas burimeve të financimit për mjetet në disponim, të alokuara, të paalokuara, të shpenzuara, të zotuar, mjetet e lira dhe progresin shprehur në %.

3.3. EKZEKUTIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2020 SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

Burimi i financimit	Buxheti Aktual	Alokimi	E pa Alokuar	Shpenzimi	Zotim /Obligimet në pritje	Mjetet e lira	Progresi ngaj planit %
FINANCIMI NGA HUAMARRJA-04	17,955.00	17,955.00	-	17,955.00	-	-	100.00%
BUXHETI-10	2,744,589.26	2,744,588.35	0.91	2,710,574.25	33,983.56	31.45	98.76%
TË HYRAT VETANAKE-2020 (Fondi 21)	317,865.00	222,209.64	95,655.36	187,495.58	12,834.78	117,534.64	58.99%
TË HYRAT VETANAKE- 2019 (Fondi 22)	85,891.91	85,891.91	0.00	84,716.27	1,000.01	175.63	98.63%
DONACIONET-(30-49-59-60-61)	111,167.42	111,167.42	0.00	86,470.60	0.00	24,696.82	77.78%
TOTALI	3,277,468.59	3,181,812.32	95,656.27	3,087,211.70	47,818.35	142,438.54	94.20%

Komente dhe shpjegime:

Buxheti nga financimi i huamarrjes ne arsim (fondi 04)

Ka qenë në shumë prej 17,955.00 €, prej tyre mjete të shpenzuara kemi në shumë prej 17,955.00 € apo 100.00%.

Buxheti nga grantet qeveritare (fondi 10)

Ka qenë në shumë prej 2,744,589.26 €, prej tyre mjete të shpenzuara kemi në shumë prej 2,710,574.25 € apo 98.76%, kurse suficit kanë mbet shuma prej 34,015.01 € apo 1.24%, ku nga kjo shumë një pjesë e tyre prej 28,791.93 € janë kthyer nga MF-ja si mjete të pashpenzuara pa fajin e komunës, mirëpo nuk kanë arritur të procedohen në bankë, përkatësisht janë refuzuar nga sistemi dhe mbesin obligime për vitin 2020.

Buxheti nga të hyrat vetanake 2020 (fondi 21)

Ka qenë në shumë prej 317,865.00 €, prej tyre mjete të shpenzuara kanë qenë në shumë prej 187,495.58 € apo 58.99 %, pastaj mjetet që barten për vitin 2021 janë në shumë prej 56,604.24 € apo 17.81%, ndërsa mjete te pa alokuara që nuk kemi mundur me e përmbush planin e të hyrave vetanake janë edhe 73,765.18 € apo 23.21%.

Buxheti nga të hyrat vetanake të bartura 2019 (fondi 22)

Ka qenë në shumë prej 85,891.91 €, prej tyre mjete të shpenzuara kemi në shumë prej 84,716.27 € apo 98.63%, ndërsa mjetet që barten në vitin vijues janë në shumë prej 1,175.64 € apo 1.37%.

Buxheti nga donacionet (fondet 32-49-59-60-61)

Ka qenë në shumë prej 111,167.42 €, prej tyre mjete të shpenzuara janë në shumë prej 86,470.60 € apo 77.78%, kurse mjete të pashpenzuara kanë mbet në shumë prej 24,696.82 € apo 22.22% dhe këto mjete barten në vitin 2021 .

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin fiskal 2020 ka qenë në shumë prej 3,277,468.59 €, prej tyre shpenzimi është në lartësi prej 3,087,211.70 € apo 94.20%, ndërsa mjetet e pashpenzuara (mjetet e zotuar dhe të lira) janë në shumë prej 190,256.89 € apo 5.80%.

